

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 442/13

Data: 2 prill 2014

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, kryetare dhe gjyqtare raportuese, dhe gjyqtarëve kosovar të Gjykatës së Apelit Vahid Halili dhe Mejreme Mema si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Beti Hohler, zyrtare ligjore e EULEX-it,

në lëndën penale kundër

K.P., i biri i Zefit dhe nënës **M.** (nga gjinia **M.**), i lindur më 30.05.1958 në fshatin xxx, komuna xxx banues në xxx, me profesion xxx, me gjendje të mesme ekonomike, xxx, shtetas i Kosovës, aktualisht në vuajtje të dënimit në burgun e xxx në lëndën nr. P 477/11 të Gjykatës së Qarkut të Pejës (aktgjykimi i Gj/Q të Pejës nr. P 477/11 i datës 24.05.2012 i formës së prerë) lidhur me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PaKr 1122/12 të datës 25.04.2013);

i dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin nr. P 86/13 të Gjykatës Themelore të Pejës, të datës 14 qershor 2013 për veprën penale të *Keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar* sipas neneve 3(2), 31, 422(1) të Kodit penal të Republikës së Kosovës - Ligji nr. 04/L-082 (KPRK 2013);

duke vendosur rreth ankesave në vazhdim të ushtruara kundër aktgjykimit nr. P 359/12 të Gjykatës Themelore të Pejës, të datës 14 qershor 2013 (tash e tutje në tekst: aktgjykimi i kundërshtuar):

- **Ankesa e të pandehurit K.P. e parashtruar më 12 gusht 2013,**
- **Ankesa e avokatit mbrojtës Gëzim Balloku në emër të të pandehurit K.P. e ushtruar më 29 korrik 2013;**

pas shqyrtimit të mendimit të prokurorit të apelit të shtetit nr. PPA/I 404/13 të datës 19 nëntor 2013, i paraqitur në Gjykatën e Apelit më 20 nëntor 2013;

pas mbajtjes së seancës publike më 2 prill 2014 në praninë e të pandehurit dhe prokurorit të apelit të shtetit Xhevdet Bislimi;

pas këshillimit dhe votimit më 02 prill 2014;

në bazë të neneve 389, 390, 394, 398 dhe 402(1) të Kodit të Procedurës Penale – Ligjit nr. 04/L-123 (KPP);

sjell këtë:

AKTVENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit Gëzim Balloku në emër të të pandehurit **K.P.**, e ushtruar më 29 korrik 2013 kundër *aktgjykimit nr. P 359/12 të Gjykatës Themelore të Pejës të datës 14 qershor 2013.*

Pjesërisht pranohet ankesa e të pandehurit **K.P.**, e ushtruar më 12 gusht 2013 kundër *aktgjykimit nr. P 359/12 të Gjykatës Themelore të Pejës të datës 14 qershor 2013.*

Aktgjykimi nr. P 359/12 i Gjykatës Themelore të Pejës i datës 14 qershor 2013 kundër K.P. priset dhe lënda kthehet në rigjykim dhe vendosje në Gjykatën Themelore të Pejës.

ARSYETIMI

I. PROCEDURA E DERITANISHME E KËSAJ LËNDE

1. Prokurori special më 23 korrik 2012 ka ngritur aktakuzën nr. PPS 07/2011 pranë (ish) Gjykatës së Qarkut të Pejës. Aktakuza është ngritur ndaj të pandehurit **K.P.** dhe të pandehurit **A.R.** për veprën penale të *Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit* sipas nenit 339, par. (1), lidhur me par. (3) të Kodit penal të Kosovës (KPK),¹ lidhur me veprën penale të *Keqpërdorimit të besimit* sipas nenit 269, par. (1), lidhur me par. (2) të KPK-së.

2. Gjyqtari për konfirmim i Gjykatës së Qarkut të Pejës më 20 shtator 2012 ka marrë aktvendimin nr. KA 223/12. Gjyqtari për konfirmim ka vërtetuar aktakuzën për të dy të pandehurit (**K.P.** dhe **A.R.**) për veprën penale të *Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit* sipas nenit 339, par. (1) dhe (2) të KPK-së. Gjyqtari për konfirmim ka hedhur poshtë aktakuzën ndaj dy të pandehurve për veprën penale të *Keqpërdorimit të besimit* sipas nenit 269, par. (1) dhe (2) të KPK-së, për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit për ndjekje të veprës penale.

3. Shqyrtimi gjyqësor kundër të dy të pandehurve ka filluar me trupin gjykues të Gjykatës Themelore të Pejës më datën 29 janar 2013. Të njëjtën ditë trupi gjykues ndau lëndët kundër dy të pandehurve.

4. Lënda kundër **K.P.** vazhdoi vetëm më 14 qershor 2013, kur trupi gjykues solli aktgjykimin kundër të pandehurit. Trupi gjykues ka shpallur të pandehurin fajtor për veprën penale të *Keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar* në bazë të nenit 3 paragrafi (2), 31 dhe nenit 422 paragrafi (1) të KPRK-së 2013, e kryer në bashkëkryerje me **A.R.** Po të njëjtën ditë

¹ Kodi Penal në fuqi në Kosovë nga data 6.04.2004 deri më 31.12.2012.

A.R. u shpall fajtor për të njëjtën vepër penale dhe u dënua veçmas në lëndën nr. P 86/2013.² Trupi gjykues mori edhe një aktvendim për vazhdimin e paraburgimit ndaj **K.P.** deri sa aktgjykimi në lëndë të marrë formën e prerë.

5. Aktgjykimi i kundërshtuar tani është ankimuar nga mbrojtësi. Vet i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës kanë parashtruar ankesa të ndara ndaj aktgjykimit të kundërshtuar.

6. Pas marrjes së shkresave të lëndës nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit sipas shqyrtimit në pajtueshmëri me nenin 389 paragrafi (5) të KPP-së, më 26 nëntor 2013, mori aktvendimin për ndërprerjen e paraburgimit ndaj të pandehurit. Gjykata e Apelit gjeti se i pandehuri ishte tanimë duke vuajtur dënimin me burgim të formës së prerë në një lëndë tjetër, prandaj kushtet për paraburgimin e vazhduar në *këtë* lëndë nuk ishin plotësuar.

7. Gjykata e Apelit mbajti seancë publike më lëndë më 2 prill 2014 në praninë e të pandehurit dhe prokurorit të apelit të shtetit. Avokati mbrojtës i të pandehurit ishte ftuar sipas rregullit në seancë por nuk mori pjesë.

II. PARASHTRESAT E PALËVE

8. I pandehuri ka parashtruar ankesë më 12 gusht 2013 për arsye të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së kodit penal. Ai pohon për shkelje substanciale procedurale sipas nenit 384 paragrafi (2) nën paragrafi 2.1) të KPP-së përmes shkeljes së nenit 233 paragrafi (8) të KPP-së. Neni i referuar në mënyrë eksplicite përcakton që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij të jenë të pranishëm gjatë negociatave të pranimit të fajësisë. Ai pohon se atij asnjëherë nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë ose të jetë i pranishëm në diskutime me prokurorinë e lëndës. Ai e ka nënshkruar procesverbalin në ndërtesën e Gjykatës Themelore të Pejës. Si provë, ai e ka bashkangjitur vërtetimin e lëshuar nga Shërbimi korrektues i Dubravës më 23 korrik 2013.

9. Në lidhje me shkeljen e kodit penal, i pandehuri pohon se sipas nenit 106 paragrafi (1) nën paragrafi 1.4) të KPK-së, parashkrimi relativë ka skaduar, që në rastin e tij është 5 vjet pas kryerjes së veprës penale më 14 qershor 2005. Aktvendimi mbi inicimin e hetimeve ishte marrë më 16 shkurt 2011, pra në mënyrë të qartë më tepër se 5 vjet më vonë. Për më tepër neni 81 i KPK-së (kryerja në vazhdimësi e veprës penale) ishte shkelur me ndarjen e kësaj lënde nga lëndët e tjera për të cilat ai tashmë ishte ndjekur penalisht. Kjo ishte bërë në dëm të të pandehurit. Vepra penale në lëndën aktuale ishte kryer gjatë të njëjtës periudhë kohore sikur të tjerat kundër të njëjtit subjekt, prandaj kjo është dashur të konsiderohet dhe ndiqet penalisht bashkë me veprat e tjera. Edhe Gjykata Themelore gabimisht shqiptoi dënimin plotësues të “ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publik dhe në shërbimin publik” sepse profesioni i një xxx nuk i takon funksioneve të administratës ose shërbimeve publike.

² Gjykata e Apelit me aktgjykimin nr. PAKR 441/13 të datës 02.04.2014 e prishi aktgjykimin e Gjykatës Themelore kundër Avdullah Robajt dhe e refuzoi akuzën kundër të pandehurit.

10. I pandehuri propozon që aktgjykimi i kundërshtuar të priset dhe kërkon nga Gjykata e Apelit ta liroj atë nga të gjitha akuzat ose ta anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

11. Avokati mbrojtës Gëzim Balloku më 29 korrik 2013 parashtrioi ankesë për arsye të shkeljeve të ligjit penal dhe kundërshtoi vendimin mbi sanksionin penal. Avokati mbrojtës i propozon Gjykatës së Apelit për ta ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar dhe të refuzoi akuzat për shkak të parashkrimit relativë ose të shqiptojë një dënim më të butë ndaj të pandehurit. Ai paraqet se sipas kodit të ri penal, vepra penale e *keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar* është e dënueshme deri në 5 vjet burgim, pra parashkrimi relativë ka kaluar pasi që vepra penale ishte kryer më 2004 dhe 2005 dhe hetimet kanë filluar vetëm në shkurt 2011.

(Përgjigja e prokurorit special)

12. Prokurori special në lëndë nuk ka paraqitur përgjigje ndaj ankesave.

(Propozimi i prokurorit të apelit të shtetit)

13. Në propozimin e tij të datës 19 nëntor 2013, prokurori i apelit i shtetit i propozon Gjykatës së Apelit t'i refuzoj si të pabazuara ankesat e të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës dhe të vërtetojë aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës Themelore të Pejës.

III. KOMPETENCA E GJYKATËS SË APELIT

14. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi ankesat sipas neneve 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat - Ligji nr. 03/L-199.

15. Kolegji i apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë - Ligji nr. 03/L-053. Sipas vendimit të kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it nr. 2014.OPEJ.0129-0001 të datës 12 mars 2014, i sjellë në përputhshmëri me nenin 3.7. të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kolegji ishte i përbërë nga një gjyqtar i EULEX-it dhe dy gjyqtarë kosovar të Gjykatës së Apelit. Nuk ka pasur asnjë kundërshtim nga palët ndaj përbërjes së kolegjit.

IV. GJETJET MBI MERITAT

16. Ankesat e mbrojtësit janë të ushtruara në kohë dhe janë të pranueshme.

17. Ankesa e avokatit mbrojtës refuzohet si e pabazuar, ndërsa ankesa e të pandehurit pranohet pjesërisht.

Shkeljet e pohuara substanciale të procedurës penale (neni 384 i KPP-së)

Shkeljet e nenit 233 të KPP-së lidhur me nenin 384(2) të KPP-së

18. Në ankesën e tij, i pandehuri **K.P.** pohon se asnjëherë nuk i është dhënë mundësia të marrë pjesë ose të jetë i pranishëm në diskutime me prokurorin lidhur me marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe e ka nënshkruar “procesverbalin mbi arritjen e marrëveshjes së pranimit të fajësisë” në ndërtesën e Gjykatës Themelore të Pejës.

19. Fillimisht kolegji vëren se trupi gjykues i Gjykatës Themelore në këtë procedim nuk e ka kuptuar procedurën e marrëveshjes për pranimin e fajit sipas KPP-së. Trupi gjykues në mënyrë efektive ka pranuar dokumentin e emërtuar “procesverbali i arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë” të datës 29 janar 2013 si marrëveshje me shkrim e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 233 të KPP-së. Kryetari i trupit gjykues e ka njoftuar të pandehurin se ai do të dënohet në përputhshmëri me “marrëveshjen e pranimit të fajësisë”. Trupi gjykues pas kësaj ka mbyllur seancën dëgjimore. I pandehuri u soll edhe njëherë para trupit gjykues vetëm më 14 qershor 2013, kur trupi gjykues shpalli aktgjykimin dhe e dënoi të pandehurin.

20. Gjykata Themelore ka kryer shkelje serioze të procedurës penale në këtë lëndë. Kolegji pajtohet me mbrojtësin se këto shkelje kanë mundur të ndikojnë në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë.

21. Së pari, kolegji konsideron se dokumenti i emërtuar “procesverbali i arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë” i datës 29 janar 2013 nuk mund të merret si marrëveshje për pranimin e fajësisë në kuptim të nenit 233 të KPP-së. Dokumenti, sikurse është evidente nga vet emri i tij e edhe më tepër nga përmbajtja, është një procesverbal i takimit të mbajtur për të diskutuar një marrëveshje të mundshme të pranimit të fajësisë.

22. Dokumenti nuk e plotëson kriterin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë të paraparë me nenin 233 paragrafi (12) të KPP-së. Dokumenti, në veçanti, nuk e përcakton në mënyrë të qartë se për cilat akuza i pandehuri e pranon fajësinë (kjo gjithsesi duhet të përfshijë edhe përshkrimin faktik edhe cilësimin juridik) ose të drejtat nga të cilat mund të hiqet dorë.

23. Çfarë është edhe më shumë shqetësuese është kushti në “procesverbalin e arritjes së marrëveshjes së pranimit të fajësisë”, që nëse i pandehuri e pranon fajësinë ai do të dënohet me afat të caktuar burgimi. Prokurori nuk mund të bëjë garantime të tilla pasi që çdo dënim i propozuar nuk është detyrues për gjykatën. Marrëveshja e pranimit të fajësisë *mund* të përmbajë një dispozitë në të cilën palët pajtohen për *kufirin* e dënimit të cilin prokurori ia propozon gjykatës por në asnjë mënyrë nuk e detyron gjykatën. (shin nenin 233(12) të KPP-së).

24. Më tej, kur gjykata e pranon marrëveshjen e pranimit të fajësisë, gjithsesi duhet të urdhërojë që e njëjta zyrtarisht të parashtrohet në gjykatë dhe pas kësaj një datë duhet të caktohet për palët që të japin deklaratat e tyre lidhur me dënimin pas së cilës gjykata e shqipton dënimin (neni 233(21) i KPP-së). Palëve në këtë lëndë nuk u është dhënë asnjë mundësi për të shprehur

pikëpamjet e tyre rreth dënimit, të ngrehin rrethanat lehtësuese ose rënduese ose të bëjnë parashtrësia të tjera.

25. Kolegji po ashtu thekson se madje edhe në rast se gjykata nuk do të respektonte marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe të konsideronte se i pandehuri pranoi fajësinë, dispozitat e KPP-së mbeten të shkelura. Edhe kur pranohet fajësia, Gjykata Themelore gjithsesi duhet të dëgjojë fjalën përfundimtare të palëve para se të bëhet tërheqja për këshillime dhe pastaj marrja e aktgjykimit. Dhe kjo procedurë nuk është respektuar aspak në këtë lëndë.

26. Nga procesverbali i seancës i datës 14 qershor 2013 është e dukshme se i pandehuri ishte sjellë në gjykatë dhe trupi gjykues vetëm shpalli aktgjykimin.

27. Kolegji i konsideron këto shkelje të jenë të një peshe të tillë që të njëjtat mundë të kenë ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë. E në veçanti kur i bashkëngjitet edhe një numër shkeljesh të tjera substanciale procedurale (sikurse diskutohet më poshtë), kjo lëndë gjithsesi duhet të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore.

Shkelja e nenit 384(1)12) të KPP-së – aktgjykimi nuk është përpiluar në përputhshmëri me kushtet e nenit 370 të KPP-së dhe ka kundërthënie në mes të dispozitivit dhe aktgjytimeve të arsyetuara të cilët janë shpallur

28. Sipas nenit 394 paragrafi (1) të KPP-së, Gjykata e Apelit gjithsesi, në mes tjerash, *ex officio* duhet të shqyrtojë nëse në këtë lëndë ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 paragrafi (1) nën paragrafët 1.1.), 1.2.), 1.6.) dhe 1.8) deri në 1.12) të KPP-së.

29. Kolegji konsideron se aktgjykimi i kundërshtuar nuk ishte hartuar në përputhshmëri me nenin 370 të KPP-së dhe shkeljet përbënin shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 paragrafi (1) nën paragrafi 12) të KPP-së.

30. Së pari kolegji konstaton se formulimi i dispozitivit në aktgjykimin e kundërshtuar nuk është plotësisht i njëjtë me formulimin e aktgjykimit të shpallur më 14 qershor 2013. Kjo nënkupton se shpallja e dënimit ndryshon.

31. Në pjesën relevante që ka të bëjë me dënimin e shqiptuar me burgim, trupi gjykues më 14 qershor 2013 shpalli këtë:

“[...] prandaj për arsyen e përmendur më lart, gjykata shqipton këto dënime:

- Për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare e kryer në bashkëkryerje dhe duke pasur parasysh marrëveshjen e tij të pranimit të fajësisë me PSRK-në (një dënim i pajtuar prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj) dhe dënimet e mëparshme, K.P. dënohet me burgim unik prej njëmbëdhjetë (11) vjet e gjashtë muaj. [...]”

Në aktgjykimin e arsyetuar të datës 14.06.2013 dhe të dorëzuar palëve, dispozitivi në pjesën relevante lidhur me dënimin e shqiptuar me burgim përmban me sa vijon:

“[...]prandaj për arsyen e përmendur më lart, gjykata shqipton këto dënime:

- për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare të kryer në bashkëkryerje i pandehuri K.P. dënohet me dënim unik prej një (1) viti e gjashtë muaj burgim”.

32. Dispozitivët prandaj dallojnë shumë nga njëri tjetri në këtë pjesë. Në aktgjykimin e shpallur do të ishte dukur se trupi gjykues nuk ka shqiptuar dënimin por vetëm ka shqyrtuar dënimin në “marrëveshjen për pranimin e fajësisë” ashtu siç duhet të zbatohet. Për këtë arsye, kolegji duket se ka pasur parasysh dënimin e mëhershëm të të pandehurit dhe pastaj ka shqiptuar dënimin unik prej 11 vjetësh e gjashtë muajsh. Në aktgjykimin e arsyetuar, nga ana tjetër, kolegji tash e ka vërtetuar dënimin për veprën penale duke e shqyrtuar dënimin prej një viti e gjashtë muajsh. Prandaj, askund nuk përmendet dënimi unik si në aktgjykimin e shpallur. Megjithatë, në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të kundërshtuar, trupi gjykues ka deklaruar se nëse janë të autorizuar për të caktuar dënimin unik atëherë ata do ta zgjidhnin dënimin unik prej 11 vjetësh e gjashtë muajsh.

33. Trupi gjykues, siç del nga arsyetimi, ka qenë i pasigurt rreth kompetencave të veta. Por në vend se të miratonin një interpretim të tyre dhe të merrnin vendimin, trupi gjykues nuk e ka bërë fare një gjë të tillë, por duke dëshiruar një zgjidhje më të përshtatshme, kishte tentuar t’i “bënte të dyja veprimet në të njëjtën kohë”.

34. Për më tepër, duke pasur parasysh mospërputhjen e dispozitivëve të aktgjykimit të shpallur dhe të arsyetuar, është e paqartë se çfarë ka qenë në fakt dënimi i shqiptuar, prandaj kjo vetvetiu duhet domosdo të rezultojë me anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar.

35. Për më tepër, trupi gjykues ka bërë shkeljen e radhës gjatë hartimit të dispozitivit, pasi që në të nuk përfshihet akuza për të cilën është dënuar i pandehuri. Neni 370, par. (4) i KPP-së, lidhur me nenin 365, par. (1.1) të KPP-së përcakton pa ekuivok që aktgjykimi me të cilin shpallet fajtor i akuzuari duhet patjetër ta përshkruajë veprën për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat të cilat e tregojnë natyrën penale të veprës së kryer si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal.

36. Në aktgjykimin e kundërshtuar, dispozitivi nuk përmban *asnjë* përshkrim të fakteve për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor. Nuk thuhet asgjë lidhur me atë se kur, ku dhe si është kryer vepra penale. Dispozitivi vetëm thekson se “i pandehuri **K.P.** ka marrë pjesë në procedurë të kundërligjshme e cila ka rezultuar me humbjen prej 71.257.40 eurosh të kompanisë kosovare të sigurimeve – *njësia e sigurimit të detyrueshëm në Prishtinë*”.

37. Në esencë, nuk mund të arrihet gjer tek përfundimi se cilat veprime kriminale i ka kryer i pandehuri gjatë kohës së leximit të dispozitivit. Kjo gjë është gjithmonë thelbi i secilit aktgjykim dhe gjithashtu i përcakton parametrat formale dhe materiale të parimit *res iudicata*.

38. Pasi që dispozitivi është hartuar në tërësi në kundërshtim me nenin 370 të KPP-së dhe nuk është e qartë se për cilat fakte i pandehuri në të vërtetë është shpallur fajtor (kur të krahasohet me veprimet e pohuara në aktakuzën e datës 23 korrik 2012), kolegji nuk ka zgjedhje tjetër përveç se ta kthejë lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim dhe rivendosje.

Shkelja e pohuar e ligjit penale – skadimi i afatit të parashkrimit

39. Mbrojtja pretendon se afati kohor për ndjekjen penale në këtë lëndë ka skaduar, pasi që hetimet ndaj të pandehurit nuk kanë filluar me kohë para skadimit të afatit të parashkrimit në bazë të nenit 106, par. (1), nënpar. 1.4. të KPRK-së së vitit 2013.

40. Dënimi i përcaktuar për veprën penale sipas nenit 422, par. (1) të KPRK-së së vitit 2013 (*Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*) është burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet. Në bazë të nenit 106, par. (1), nënpar. 1.4 të KPRK-së së vitit 2013, afati i parashkrimit për veprën përkatëse penale, duke u mbështetur në dënimin maksimal të përcaktuar, është pesë vjet.

41. Neni 107, par. (1) i KPRK-së së vitit 2013 përcakton se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Sipas aktakuzës nr. PPS 07/2011 të datës dhe e parashtruar më 23 korrik 2012, i pandehuri pohohet se e kishte kryer veprën penale në fjalë më 14 qershor 2005.³

42. Kolegji vëren se Gjykata e Apelit e kishte refuzuar akuzën ndaj të bashkëpandehurit të **K.P.jt** në këtë lëndë – të pandehurit **A. R.** për shkak se kishte kaluar afati i parashkrimit para se të fillohej me hetimet penale (shih aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, nr. PaKR 441/13 të datës 2 prill 2014). Kolegji lidhur me këtë lëndë ka refuzuar interpretimin e Gjykatës Themelore se për shkak se prokurori ka filluar hetimet brenda afatit të parashkrimit i cili ka qenë në fuqi në atë kohë, trupi gjykues duhet patjetër ta shqyrtojë vetëm skadimin absolut që përcaktohet me nenin 107, par. (8) të KPP-së. Kolegji në vend të kësaj ka konstatuar se kur të ketë ndryshime në ligjin material, si në rastin në fjalë, gjykata është e obliguar të bëjë vlerësimin nëse ndjekja penale ka filluar në mënyrë ligjore apo jo në bazë të *ligjit të tanishëm në fuqi*. Po qe se kjo gjë do të thotë se ndjekja nuk ka filluar me kohë, atëherë akuza duhet domosdo të refuzohet.⁴

43. Sa i përket asaj se kur “ka nisur ndjekja”, kolegji konstaton si në vazhdim: **Z.M.**⁵ në këtë lëndë ka parashtruar kallëzimin penal më 5 janar 2011.⁶ Prokurori ka marrë aktvendimin mbi

³ Shih pjesën akuzuese të aktakuzës nr. PPS 07/2011 të datës dhe të parashtruar më 23 korrik 2012, f. 4.

⁴ Shih arsyetimin e detajuar të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nr. PaKR 441/13 të datës 2 prill 2014, par. 18-29.

⁵ Kolegji vëren se trupi gjykues gjatë tërë procedurës gabimisht e ka konsideruar **Z.M.** si palë e dëmtuar. Ky i fundit nuk i plotëson kriteret për të qenë palë e dëmtuar në këtë procedurës penale dhe prandaj nuk e ka një status të tillë.

⁶ Kolegji e vëren se kallëzimi penal e mban datën 28.12.2010 ndërsa është i vulosur me vulën pranuese të plotësuar me shkrim dore me datën 05.01.2010. Kolegji vëren se duke pasur parasysh se dokumenti në fjalë e mban datën 28.12.2010, vula duhej të mbante datën 05.01.2011. Referimi i vitit 2010 në pikëpamjen e kolegjit është një gabim shtypi.

fillimin e hetimeve ndaj **A. R.** më 16 shkurt 2011. Kolegji vëren se më datën 4 shkurt 2011 prokurori tashmë kishte zhvilluar intervistën me dëshmitarin **Z.M.** lidhur me kallëzimin penal të cilin e kishte parashtruar kundër të pandehurve **P. dhe R.**⁷ Në bazë të nenit 107, par. (5) të KPRK-së së vitit 2013, afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës së kryer. Kolegji konsideron se marrja në pyetje e personit i cili ka parashtruar kallëzimin penal ka qenë një veprim i ndërmarrë për qëllim të ndjekjes penale prandaj ky veprim e ka ndërprerë afatin e parashkrimit dhe jo marrja e aktvendimit mbi nisjen e hetimeve. Data përkatëse për t'u konsideruar si fillimi i çfarëdo veprimi procedural ka qenë data 4 shkurt 2011.

44. Neni 106, par. (6) i KPRK-së së vitit 2013 më tej përcakton se *afati i parashkrimit po ashtu ndërpritet kur kryerësi para skadimit të afatit të parashkrimit kryen një vepër tjetër penale me peshë të njëjtë ose më të rëndë sesa vepra penale e mëparshme.*

45. I pandehuri **K.P.** pohohet se ka kryer në këtë lëndë vepër penale më 14 qershor 2005. Por në mes të 12 shtatorit 2007 dhe 8 prillit 2008, i pandehuri po ashtu ka kryer veprën penale të *marrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore* sipas nenit 346 të kodit të vjetër KPK, e cila është vepër penale me peshë të rëndë sikur vepra që shqyrtohet në këtë lëndë penale. I pandehuri në fjalë është shpallur fajtor për veprën e fundit penale me aktgjykimin e formës së prerë së Gjykatës së Qarkut të Pejës (lënda nr. P 477/11, të datës 24.05.2012), të ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit nr. PaKr 1122/12 të datës 25 prill 2014.⁸

46. Për këtë arsye, afati i parashkrimit i cili ka filluar të ecë më 15 qershor 2005 është ndërprerë jo më vonë sesa më 8 prill 2008, kur i pandehuri ka kryer veprën penale e cila trajtohet në lëndën penale nr. P 477/11 të Gj/Th-së së Pejës (Lënda e Gjykatës së Apelit nr. PaKr 1122/12).

47. Sipas nenit 107, par. (6) të KPRK-së së vitit 2013, ecja e afatit të parashkrimit është ndërprerë dhe në bazë të nenit 107, par. (7) të KPRK-së së vitit 2013 pas ndërprerjes ka filluar rishtas. Rrjedhimisht, kur ndjekja penale për këtë vepër penale ka filluar më 4 shkurt 2011, nuk kishte skaduar akoma afati i parashkrimit relativ të veprës penale.

48. Si përfundim, ndjekja penale kundër **K.P.** nuk kishte skaduar akoma kur pati filluar rishtas më 4 shkurt 2011. Ankesa e mbrojtjes lidhur me çështjen e parashkrimit prandaj refuzohet.

49. I pandehuri po ashtu ka ngritur kundërshtimin ndaj zbatimit të ligjit penal lidhur me shqiptimin e dënimeve plotësuese dhe çështjen e veprës penale në vazhdimësi. Megjithatë, pasi

⁷ Shih procesverbalin e seancës dëgjimore të palës së dëmtuar, PPS 07/2011, të datës 4.02.2011, shkresat e gjykatës, shkresat e lëndës së gjykatës, dengu nr. I, tab. 31-1

⁸ Vetë i pandehuri gjatë seancës së Gjykatës së Apelit më datën 2 prill 2014 i është referuar arsyetimit të këtij aktgjykimi, sa i përket cilësimit juridik të veprës penale në fjalë (shih më lart).

që lënda kthehet për rigjykim Gjykata e Apelit nuk ka nevojë t'i shqyrtojë këto pretendime, pasi që aktgjykimi anulohet.

Vërejtjet lidhur me ligjin penal në fuqi

50. Kolegji e vërteton se ligji penal në fuqi për këtë lëndë është Kodi i ri Penal i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013. Edhe pse vepra e pohuar penale është kryer më 2005, sipas nenit 3, par. (2) si ligj më i favorshëm për të pandehurin si kod i zbatueshëm merret kodi i ri penal.

51. Siç është interpretuar me të drejtë nga Gjykata Themelore, dënimi i përcaktuar për veprën penale të *keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar*, me të cilën akuzohet i pandehuri, është më i butë me kodin e ri KPRK të vitit 2013 – burgim deri në 5 vjet sipas nenit 422, par. (1) të KPRK-së së vitit 2013 për dallim nga burgimi deri në 8 vjet në bazë të nenit 339, par. (3) të kodit të mëhershëm penal.

52. I pandehuri gjatë seancës së Gjykatës së Apelit më 2 prill 2014 është thirrur në arsyetimin e Gjykatës së Apelit në aktgjykimin e tyre nr. PaKr 1122/12 të datës 25 prill 2013 kundër të të njëjtit të pandehur dhe ka pretenduar se cilësimi i saktë juridik i veprave të pohuara penale është *nxjerrje e vendimeve të kundërligjshme gjyqësore* sipas nenit 432 të KPRK-së së vitit 2013 (më herët neni 346 i KPK-së).

53. Pasi që kjo lëndë kthehet për rigjykim, do të varet nga trupi gjykues që në gjykimin e ri ta vlerësojë se cilin cilësim juridik ta zbatojë. Në këtë fazë, kolegji vetëm vëren se vepra penale *nxjerrje e vendimeve të kundërligjshme gjyqësore* përkufizohet njësoj si në kodin e vjetër penal ashtu edhe në atë të riun. Kolegji, megjithatë, në mënyrë specifike thekson mospërputhjen në dënimin e përcaktuar në mes të versionit në shqip dhe në anglisht të kodit penal. Në versionin anglisht, sipas nenit 432, kemi këtë formulim:

Neni 432 (Nxjerrje e vendimeve gjyqësore të kundërligjshme)

Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Përderisa në versionin shqip të nenit 432 thuhet si vijon:

Neni 432 (Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore)

Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

... i cili, i përkthyer në anglisht, do të kishte këtë kuptim:

Neni 432 (Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore)

Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

54. Prandaj, versioni në anglisht i kodit e përcakton dënimin me “gjobë dhe me burgim prej 6 (gjashtë) muajsh deri në 5 (pesë) vjet.” Kolegji në mënyrë specifike ia tërheq vëmendjen Gjykatës Themelore lidhur me këtë mospërputhje, në rast se Gjykata Themelore do ta cilësonte veprën penale në bazë të kësaj dispozite.

Udhëzimi i Gjykatës Themelore për ta rigjykuar lëndën

55. Pas anulimit të aktgjykimit të kundërshtuar dhe kthimit të lëndës penale për rigjykim pranë Gjykatës Themelore, kolegji vëren se për rigjykim Gjykata Themelore duhet t'i ftojë të gjitha palët në përputhje me KPP-në si dhe duhet ta fillojë rishtas shqyrtimin gjyqësor. Kolegji e vëren se vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet asaj se kush konsiderohet të jetë palë e dëmtuar në këtë lëndë. Trupi gjykues gjatë gjykimit të parë e kanë përcaktuar **Z.M.** dhe disa persona të tjerë si palë të dëmtuara. KPP-ja është e qartë lidhur me përkufizimin se kush konsiderohet palë e dëmtuar në procedurën penale prandaj Gjykata Themelore duhet ta respektojë ligjin lidhur me këtë aspekt.

56. Për më tepër, siç e ka vërtetuar Gjykata e Apelit, “procesverbali mbi arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë” i datës 29 janar 2013 nuk përbën marrëveshje për pranimin e fajësisë sipas nenit 233 të KPP-së. Përderisa palët janë të lira për të hyrë në marrëveshje të caktuar për pranimin e fajësisë, nëse vendosin për të bërë një gjë të tillë, kjo duhet patjetër të bëhet në përputhje të plotë me nenin 233 të KPP-së, përndryshe marrëveshja për pranimin e fajësisë nuk mund të jetë e vlefshme. Përndryshe, i pandehuri natyrisht se ka të drejtë, në qoftë se vendos kështu, që të deklarohet fajtor në hapje të shqyrtimit gjyqësor. Në qoftë se i pandehuri deklarohet i pafajshëm, Gjykata Themelore do të vazhdojë duke e zhvilluar një shqyrtim të plotë gjyqësor në përputhje me KPP-në. Çdo aktgjykim i marrë në këtë lëndë, duhet të përputhet me nenin 370 të KPP-së.

57. Kolegji, si vërejtje të fundit, po ashtu thekson se në bazë të nenit 107, par. (8) të KPRK-së së vitit 2013 lidhur me nenin 106, par. (1), nënpar. (1.4) të KPRK-së së vitit 2013, se 10 vjet të afatit absolut të parashkrimit do të skadojnë më datën 14 qershor 2015, pas së cilës datë do të skadojë afati i ndjekjes penale të kësaj lënde. Kolegji prandaj e nxit Gjykatën Themelore që ta caktojë fillimin e rigjykimit sa më shpejt që është e mundur dhe ta zhvillojë procedurën në mënyrë të përshpejtuar.

58. Për arsyet e përmendura më lart, kolegji në bazë të nenit 402, par. (1) të KPP-së e anulon aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Pejës nr. P 359/12 të datës 14 qershor 2013 dhe ia kthen lëndën në fjalë Gjykatës përkatëse Themelore për rigjykim dhe rivendosje.

Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar më datën 14 maj 2014.

Kryetarja e kolegjit

Hajnalka Veronika Karpati

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

Mejreme Mema

Gjyqtare

Anëtari i kolegjit

Vahid Halili

gjyqtar

Procesmbajtësja

Beti Hohler
Zyrtare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Pakr 442/13

02.04.2014